



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 9452 Prot

Shkodër, më 23.04.2026

**Lënda: DËRGIM PROJEKT - VENDIM DHE RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER**

Të nderuar këshilltarë !

Bashkangjitur ju dërgojme projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues " **Për shtesë në buxhetin e vitit 2026 e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër"**, i ndryshuar.

Duke ju uruar punë të mbarë !

Me respekt,

Ky projekt-vendim dhe relacion përmban këtë dokumentacion:

- Shkresë përcjellëse 1 (një) Fletë
- Projektvendim 3 (tre) Fletë
- Relacion 2 (dy) Fletë.

KRYETAR
Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
Zv. KRYETAR
Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 9452/11 Prot

Shkodër, më 23.04.2026

PROJEKT- VENDIM

"PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 E MIRATUAR ME "VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.84 DATË 18.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR.

Këshilli i Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës _____.2026, me propozim te Kryetarit te Bashkisë, mbështetur ne ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54 shkronja "dh"; ligji nr.45/2019 "Per Mbrojtjen Civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKM nr.414 date 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të perdorimit të fondeve të kushtezuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" i ndryshuar, neni 3,3.1, germat a,b,dh, ligji nr.68/2017 "Për financat vendore" i ndryshuar, Udhëzimi i perbashkët i Ministrise së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriterët dhe procedurat e dhënies së ndihmës shteterore financiare, për mbulimin e demeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, shkresës nr.429/6 prot. datë 15.04.2026 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile", "Dergohet miratimi për shpërdarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2026" të Ministrisë së Mbrojtjes ,VKB nr. 84 , date 18.12.2025 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar , dhe "Relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër nr. _____ datë _____.

VENDOSI:

I. Të miratoje shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026 alokuar në programin **10910 “Emergjencat Civile”, Artikulli.231 dhe Artikulli.604** prej **21,847,320 lekë** e detajuar si më poshtë:

1. Për programin **10910, Artikulli.231**, me Kod produkti **21AD502**—“Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile” vlera e përlogaritur është **10,923,660 lekë**.

2. Për programin **10910, Artikulli.604**, me Kod produkti **91707AB**- “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”, vlera e përlogaritur është **10,923,660 lekë**.

II. Të miratoje programin **10910, Artikulli.231**, për marrjen e masave parandaluese, “Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile” kod produkti **21AD502** me vlerë është **10,923,660 lekë** si më poshtë:

1. Ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir si dhe të Urës së Mgullës.

Institucioni Likuidues	Emërtimi i Aktivitetit	Shpenzime Kapitale të trupëzuara (231)	Plani 2026
Bashkia Shkodër	21AD502 Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile “Ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir si dhe Urës së Mgullës “ Totale e ndare ne :	10,923,660	10,923,660
	Zbatim	10,606,337	10,606,337
	Supervizim	292,735	292,735
	Kolaudim	24,588	24,588

Qëllimi i këtyre investimeve është krijimi i bazës së nevojshme infrastrukture për vendosjen e urave tip “Bailey” nga Komanda Mbështetëse e Xhenios, në funksion të garantimit të kalimit të sigurt dhe të pandërprerë. Ndërtimi i mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe i mbështetëseve ndërmjetme synon sigurimin e qëndrueshmërisë strukturore të veprës, si kusht i domosdoshëm për montimin e strukturës metalike të urës. Këto ndërhyrje do të përmirësojnë aksesin, lidhjen e zonave të prekura dhe mundësinë e reagimit të shpejtë të shërbimeve emergjente dhe të komunitetit lokal.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Benet BECI

- ZV.KRYETAR

Alban Preka



- DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

Enxhet Durrës

- DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Arta Hoxha

- DREJTORIA E FINANCËS

Blerta Myrtaq

- DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE , BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE

B. Durrës

- DREJTORIA JURIDIKE

- DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Xhelmet Durrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____ 04.2026

RELACION

"PËR SHTESE NË BUXHETIN E VITIT 2026 E MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.84 DATE 18.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026- 2028 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Me shkresën nr.429/6 prot, datë 15.04.2026 "Mbi fondin e kushtezuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" te Ministrisë së mbrojtjes, nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile", është përcjellur shkresa me protokoll hyrës 9175, datë 20.04.2026, marrë në dorëzim nga Drejtoria Emergjencave Civile në datë 23.04.2026 e fondit të miratuar në masen 21,847,320 lekë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka bërë detajimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026 si më poshtë:

1. Për programin **10910, Artikulli.231**, me Kod produkti 21AD502 – "Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile" vlera e përlogaritur është **10,923,660 lekë**.

2. Për programin **10910, Artikulli.604** me Kod produkti 91707AB- "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme", vlera e përlogaritur është **10,923,660 lekë**.

Propozojme miratimin e shteses së fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026 në vlerën **21,847,320 lekë**.

Me shkresën nr.429/6 date 15.04.2026 prot. "Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2026" të Ministrisë së Mbrojtjes është akorduar fondi prej **21,847,320 lekë**.

Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",

24.05.2013 "Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare, per mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njëzore", VKM nr.414 datë 08.07.2021 "Per miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të perdorimit të fondeve të kushtezuar te buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" i ndryshuar, neni 3,3.1, germa a,b,dh, ligji nr.68/2017 "Për financat vendore" i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Per procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; shkresës nr.429/6 prot. date 15.04.2026 "Mbi fondin e kushtezuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile"; "Dergohet miratimi per shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2026" të Ministrisë së Financave "VKB nr. 84, date 18.12.2025 "Per miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkoder" , i ndryshuar, ju paraqesim propozimet si me poshte:

a. "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" kod produkti 91707AB me vlerë **10,923,660 lekë**. Ky fond të jete gjendje për përballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri ne masen 50% te vlerës së demit për raste te paparashikuara, si dhe për raste të tjera të paparashikuara per emergjencat civile gjate vitit 2026.

b. "Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile" kod produkti 21AD502 me vlerë është 10,923,660 lekë.

Me këtë shpenzim parashikojmë ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir si dhe të Urës së Mgullës.

Institucioni Likuidues	Emërtimi i Aktivitetit	Shpenzime Kapitale të trupëzuara (231)	Plani 2026
Bashkia Shkodër	21AD502 Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile "Ndërtimin e mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir si dhe Urës së Mgullës" Totale e ndare ne :	10,923,660	10,923,660
	Zbatim	10,606,337	10,606,337
	Supervizim	292,735	292,735
	Kolaudim	24,588	24,588

Qëllimi i këtyre investimeve është krijimi i bazës së nevojshme infrastrukturore për vendosjen e urave tip “Bailey” nga Komanda Mbështetëse e Xhenios, në funksion të garantimit të kalimit të sigurt dhe të pandërprerë. Ndërtimi i mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe i mbështetëseve ndërmjetme synon sigurimin e qëndrueshmërisë strukturore të veprës, si kusht i domosdoshëm për montimin e strukturës metalike të urës. Këto ndërhyrje do të përmirësojnë aksesin, lidhjen e zonave të prekura dhe mundësinë e reagimit të shpejtë të shërbimeve emergjente dhe të komunitetit lokal

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

KRYETAR
Benet BECI

Drejtori
Xhehnet DANI

ME VENDIM DELEGIMI



SHKRESA, KËRKESA
DATE 20.04.2026



PARRODIA E TITULLARIT

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Nr. 429/16 prot.

Tiranë, më 17.04.2026

Statusi: Urgjent

Lënda: Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

BASHKISË SHKODËR

Shkodër

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në kuadër të ushtrimit të detyrave institucionale, me qëllim akordimin e fondit financiar në programin "Emergjencat civile" të Ministrisë së Mbrojtjes në masën 1000 milion lekë, i cili shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas kriterëve dhe metodologjisë së përcaktuar në aneksin 10 të ligjit 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", që integron vlerësimet e riskut në nivel qarku me tregues financiarë dhe demografikë, ku pesha e riskut të shumëfishhtë zë vendin qendror në vlerësimin dhe ndarjen e fondeve për çdo bashki, ka përllëgaritur masën e transfertës së kushtëzuar për bashkinë tuaj, përkatësisht në masën 10,923,660 lekë në kodin e produktit AB dhe 10,923,660 lekë në kodin e produktit AD, miratuar nga Ministria e Financave dhe përcjellë nga Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet shkresave nr. 2688/1 prot., datë 31.03.2026 dhe 3091/2 prot., datë 08.04.2026, "Dërgim i miratimit për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2026".

Fondi i akorduar dhe i shpërndarë duhet të përdoret brenda vitit buxhetor sipas VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" dhe raportimi të realizohet sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Për sa më sipër, kërkohet përdorimi sipas përcaktimeve dhe përcjellja e raportimeve sipas parashikimit në pikën 7 të VKM-së së mësipërme.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Haki Çako

Në mungesë dhe me urdhër

**DREJTOR I DREJTORISË SË EDUKIMIT, TRAJNIMIT
DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Jonian Harka